

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA

PER VITIN KALENDARIK 2015

“PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE”

Tirane me 1 nentor 2016

Tabela e përmbajtjes

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE

Bilanci Kontabel me 31 Dhjetor 2015

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

Pasqyra e rrjedhjes se parase per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar : KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE

(Sheshi Austria)

T I R A N Ë

TE nderuar Zoterinj ,

Në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin Nr.126 datë 20.09.2016 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga Partite Politike per vitin kalendarik 2015”,si dhe në Kontratën e Shërbimit nr.3389 datë 12.10.2016 të lidhur me KQZ, kam kryer auditimin e pasqyrave financiare per fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga “Partia Socialiste e Shqiperise ” për vitin kalendarik 2015.Auditimi përfshijnë Bilancin Kontabël më 31.12.2015, Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta si dhe një përmbledhje të politikave kontabël kryesore dhe shënime të tjera shpjeguese.

Pergjegjësia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Përgatitja dhe paraqitja e sinqertë e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit është përgjegjësi e Drejtimit të "Partisë Socialiste të Shqipërisë". Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat

Pergjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, ne reference edhe te SNA 800. Këto Standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi përfshin ekzaminimin mbi bazën e testeve, të evidencës që mbështet shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e rrishtit të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre Vlerësimeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë proçedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kryesore të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit

Opinion:

Për opinion tonë , Pasqyrat Financiare bashkëlidhur, paraqesin një pamje të vërtetë e të sinqertë të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjekti " Partia Socialiste e Shqipërisë" per periudhen ushtrimore 1 janar deri me 31 dhjetor 2015 në përputhje me Ligjin 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar, Ligjin 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"dhe Standartet kombtare te kontabilitetit.

Alida DAIJA

Ekspert Kontabel i Autorizuar
RR: Ali Pashe Gucia
Tirana, Albania

01.11.2016

Pasqyrat Financiare PARTIA SOCIALISTE SHQIPERISE

Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2015

(Te gjitha balancat jane ne leke)

Nr	A K T I V E T	Me 31 Dhjetor 2015	Me 31 Dhjetor 2014
I	A K T I V E T A F A T S H K U R T R A	14,965,251	11,195,210
1	Aktivete monetare	5,363,143	1,467,383
>	Banka	4,918,782	994,144
>	Arka	444361	473,239
2	Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim	-	-
3	Aktive te tjera financiare afatshkurtra	8,838,257	8,920,607
>	Kliente per mallra,produkte e sherbime	3,420,000	2,925,006
>	Debitore,Kreditore te tjere	25,000	5,995,601
>	Tatim mbi fitimin		
>	Tvsh	5,393,257	0
>	Te drejta e detyrime ndaj punonjesve	-	-
4	Inventari	763,851	807,220
>	Lendet e para		-
>	Inventari imet	-	-
>	Prodhim ne proces	-	-
>	Produkte te gatshme		
>	Te tjera ne perdorim	763,851	807,220
>	Parapagesa per furnizime	-	-
5	Aktive biologjike afatshkurtra	-	-
6	Aktive afatshkurtra te mbajtura per rishitje	-	-
7	Parapagime dhe shpenzime te shtyra	-	-
>	Shpenzime te periudhave te ardhshme	-	-
II	A K T I V E T A F A T G J A T A	11,140,561	10,561,586
1	Investimet financiare afatgjata	-	-
2	Aktive afatgjata materiale	11,140,561	10,561,586
>	Toka		
>	Ndertesat	1,643,389	1,643,389
>	Makineri dhe paisje		
>	Aktive tjera afat gjata materiale	9,497,172	8,918,197
3	Aktive biologjike afatgjata	-	-
4	Aktive afatgjata jo materiale	-	-
5	Kapitali aksioner i pa paguar	-	-
6	Aktive te tjera afatgjata	-	-
	T O T A L I A K T I V E T E (I + I I)	26,105,812	21,756,796

Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2015
(Te gjitha balancat jane ne leke)

Nr	PASIVET DHE KAPITALI	Me 31 Dhjetor 2015	Me 31 Dhjetor 2014
I	PASIVET AFATSHKURTRA		111,431,605
1	Derivativet	-	-
2	Huamarjet	-	-
	> Overdraftet bankare	-	-
	> Huamarje afat shkuatra	-	-
3	Huat dhe parapagimet	126,366,211	111,431,605
	> Te pagueshme ndaj furnitoreve	125,394,571	110,849,710
	> Te pagueshme ndaj punonjesve	-	-
	> Detyrime per Sigurime Shoq.Shend.	763,140	581,895
	> Detyrime tatimore per TAP-in	208,500	-
	> Detyrime tatimore per Tvsh-ne	-	-
	> Parapagime	-	-
	> Te drejta e detyrime ndaj ortakeve	-	-
	> Debitore dhe Kreditore te tjere	-	-
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra	-	-
5	Provizionet afatshkurtra	-	-
II	PASIVET AFATGJATA	-	-
1	Huat afatgjata	-	-
	> Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	-	-
	> Bono te konvertueshme	-	-
2	Huamarje te tjera afatgjata	-	-
3	Grantet dhe te ardhurat e shtyra	-	-
4	Provizionet afatgjata	-	-
	TOTALI PASIVEVE (I+II)	126,366,211	111,431,605
III	KAPITALI	-100,260,398	-89,674,809
1	Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)	-	-
2	Kapitali aksionereve te shoq.meme (PF te kons.)	-	-
3	Kapitali aksionar	26,854,184	26,854,184
4	Primi aksionit	-	-
5	Njesite ose aksionet e thesarit (Negative)	-	-
6	Rezervat statutore	-	-
7	Rezervat ligjore	-	-
8	Rezervat e tjera	-	-
9	Fitimet e pa shperndara	-116,528,993	-128,298,078
10	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	-10,585,589	11,769,085
	TOTALI PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)	26,105,813	21,756,796

Pasqyrat Financiare PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE**Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2015****(Te gjitha balancat jane ne leke)**

Nr	Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve	Me 31 Dhjetor 2015	Me 31 Dhjetor 2014
	Pershkrimi i Elementeve		
1	Shitjet neto	-	-
2	Te ardhura te tjera	149,480,287	92,504,250
3	Ndrysh.ne invent.prod.gatshme e prodhimit ne process	-	-
4	Materialet e konsumuara		
5	Kosto e punes	-30,639,511	-30,871,183
	<i>Pagat e personelit</i>	-27,681,249	-28,276,868
	<i>Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore</i>	-2,958,262	-2,594,315
	<i>Shpenzimet te tjera te personelit</i>	-	-
6	Amortizimet dhe zhvleresimet	-172,826	-216,736
7	Shpenzime te tjera (Tatime+Shperblime+rrjedhese te tjera+Nentrajtime)	-129,253,539	-49,595,538
8	Totali shpenzimeve (shumat 4 - 7)	-160,065,876	-80,683,457
9	Fitimi (humbja) nga veprimtarite e kryesore (1+2+/-3-8)	-10,585,589	11,820,793
10	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara	-	-
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet	-	-
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare		-51,709
	<i>Te ardh.e shpenz. financ.nga inves.te tjera financ.afatgjata</i>	-	
	<i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat</i>		-69,184
	<i>Fitimet (Humbjet) nga kursi kembimit</i>		17,475
	<i>Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare</i>		
13	Totali i te Ardhurave dhe Shpenzimeve financiare		
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9 +/- 13)	-10,585,589	11,769,084
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-	-
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	-10,585,589	11,769,084

Pasqyrat Financiare PARTIA SOCIALISTE

Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2015

(Te gjitha balancat jane ne leke)

Nr	Pasqyra e fluksit monetar - Metoda Indirekte	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014
I	Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytezimit		
	Fitimi para tatimit	-10,585,589	11,769,085
	Rregullime per :		
	Amortizimin	172,826	216736
	Humbje nga kembimet valutore		
	Te ardhura nga Investimet		
	Shpenzime per interesa		
	Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti,si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	82,350	-1,124,569
	Rritje/renie ne Tepricen e inventarit	43,369	613,523
	Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve ,per tu paguar nga aktiviteti	14,934,606	-2,280,781
	MM te perfituara nga aktivitetet		
	Interesi i paguar		
	Tatim mbi fitimin i paguar	-	-
	MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit	4,647,562	9,193,994
II	Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
	Blerja e njesisese kontrolluar X minus parate e Arketuara		
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-751,801	-452246
	Te ardhura nga shitja e paisjeve		
	Interesi i arketuar		
	Dividentet e arketuar		
	MM neto te perdoruara ne veprimtarite investuese	-751,801	-452246
III	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	-	-
	Te ardhura nga huamarrje afatgjata	-	-
	Pagesat e detyrimeve te qerases financiare		
	Dividente te paguar / Trans Fitimi	-	-
	MM neto e perdorur ne veprimtarite Financiare	-	-
IV	Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	3,895,761	8,741,748
V	Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	1,467,383	
VI	Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	5,363,144	1,467,383

Pasqyrat Financiare PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE
Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(Te gjitha balancat jane ne leke)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALEVE TE VETA (Pasurise)

	<i>kapitali</i>	<i>Teprica e burimeve te ushtrimit</i>	<i>Totali</i>
pozicioni me 31.12.2014 I pasurise neto	26,854,184	(116,528,994)	(89,674,810)
Teprica e burimeve te ushtrimit 2015		(10,585,589)	(10,585,589)
Pozicioni më 31 dhjetor 2015 I pasurise neto	26,854,184	(127,114,583)	(100,260,399)

Shenimet jane pjese perberese e ketyre pasqyrave

- INFORMACION I PERGJITHSHEM

Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton e rregjistruar me urdhër nr.36/1, datë 15.08.1991, të Ministrit të Drejtësisë. Sipas këtij vendimi, është miratuar krijimi i Partisë, “Partia Socialiste”, me iniciale “PS” ose “PSSH”. Kryetar i saj, është **zoti EDI RAMA**.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 8580 , dt.17.02.2000 “Per Partite Politike”, Ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2001 “Per Organizatat Jofitimpruese” , Ligjit 8789, dt. 07.05.2001 “Per Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese “, nga Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi. Selia e partisë është në rrugën “Sheshi Austria”, Tiranë.

Qëllimi i krijimit: Qëllimi dhe objektivat e Partisë Socialiste të Shqipërisë janë të përcaktuara në programin dhe Statutin e saj.

Organizimi dhe drejtimi

Organet drejtuese në udhëheqjen qendrore të PSSH janë:

- Kongresi i Partisë;
- Asambleja Kombëtare;
- Kryesia e partisë;
- Kryetari i Partisë.

Gjithashtu, në statut janë përcaktuar edhe organet drejtuese në rrethe:

- Këshilli Koordinuar i Partisë në Qark;
- Asambleja Socialiste e Rrethit;
- Kryetari i Partisë së Rrethit;
- Asambleja Socialiste e Bashkisë
- Kryetari i Partisë i AS të Bashkisë.

• Burimet financiare të Partisë janë:

- Të ardhurat nga kuotacionet;
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike
- Ndihamat dhe dhurata e anëtarësisë dhe të përkrahësve të PSSH sipas ligjit për partitë politike.
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

Baza Ligjore per kryerjen e ketij misioni :

- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin nr.10374 date 10.02.2011
- Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”,
- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe kryesisht SNA 800;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë Socialiste të Shqipërisë.

-SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

-PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE E RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në perputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar,(SKRF) të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Planit Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Kontabiliteti është ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit. Sipas kësaj mënyre, fondet e përfituara në të holla, janë regjistruar në momentin e arkëtimit të tyre dhe fondet e përfituara në natyrë dhe shërbimet në momentin e kryerjes, duke i konvertuar në lekë me çmimin e tregut dhe shpenzimet janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer.

Administrimi i fondeve të përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë të përqëndruara, në Seline e Partisë Socialiste, në Qendër.

AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Elementet e aktiveve afatgjata materiale (ose “aktivet trupezuara”) jane vleresuar me kosto historike dhe pakesuar per amortizimin e akumuluar. Kosto perfshin te gjitha shpenzimet qe i atribuohen marrjes dhe perdorimit te aktivitetit.

AMORTIZIMI

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve llogaritur ne baze te metodes se zvogelimit te vleres se mbetur. Metododat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur jane rivleresuar ne daten e raportimit.Per vitin 2015 eshte aplikuar llogaritja e zhvleresimit vetem per mjetet e transportit.

INVENTARI

Inventari vleresohet me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres se realizueshme. Kostoja e inventarit perfshin shpenzime te ndodhura gjate blerjes se inventarit, kosto prodhimi ose kosto transformimi dhe kosto te tjera te lidhura me sjelljen e tyre ne kushtet dhe pozicionin ekzistues.

Mjetet monetare

Mjetet monetare perfshijne gjendjet e parave ne arkë dhe ne llogarite rrjedhese ne bankë, ne lekë.

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Të ardhurat(Burimet) regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga donatorët dhe përdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar.

Perdorimet e fondeve te njohura ne pasqyrat financiare perfshijne te gjitha pagesat e kryera per vitin 2015, dhe shpenzimet e kryera per viti 2015, por qe nuk jane paguar ne fund te vitit.

Monedha e raportuar. Si monedhë bazë raportimi eshte perdorur monedha kombëtare, Lekë. Fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë mbartur në dokumentacionin fillestar në monedhat All, USD dhe Euro GBP . Gjendjet janë përgatitur në Lekë.

Fondet dhe shpenzimet e emëtuara në monedha të huaja, janë konvertuar në Lekë, bazuar në kursin e këmbim të datës që është kryer transaksioni, dhe donacionet në natyrë janë vlerësuar në Lekë, me çmimin e tregut në momentin e përfitimit.

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë .

Tatimi mbi fitimin

Partia Socialiste e Shqiperise është organizate jofitimprurës. Si i tillë, Partia nuk paguan tatim mbi fitimin. Partia respekton dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në fund të vitit janë paraqitur me koston e tyre historike Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale, të lëshuara nga klientët apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentave origjinale kontabël.

Teprica dhe defiqiti i te ardhurave

Teprica / defiqiti midis te ardhurave dhe shpenzimeve, qe krijohet gjate vitit, pasqyrohet ne kapital (pasurine neto).

Kontributet per sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Shoqeria paguan kontributet per pensione si dhe per sigurimet shoqerore dhe shendetesore per punonjesis te saj, siq eshte parashikuar ne legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjese per pagesen e pensioneve dhe sigurimeve shendetesore. Nuk ka asnje detyrim tjetër ne lidhje me fondin per pensione dhe sigurimet shendetesore.

Organizimi i Kontabilitetit

Kontabiliteti eshte i organizuar ne perputhje me ligjin "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Partia ka ndertuar nje plan te llogarive vetjake, ne perputhje te plotë me Planin Unik Kontabel. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e financës. Kontabiliteti mbahet ne programin ALPHA.

Kontabiliteti eshte i ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit. Sipas kesaj menyre fondet e perfituara ne te holla jane regjistruar ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perfituara ne forme materiale dhe sherbimi ne mometin e kryerjes dhe shpenzimet jane pasqyruar ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer.

Mbi bazen e ketyre parimeve te kontabilitetit, ne llogaritë kontabile e ne pasqyrat financiare te Partise Socialiste, jane evidentuar e deklaruar si shpenzime edhe faturat e pranuar, por te papaguara, ndaj furnitorëve te ndryshem, per sherbimet e perfituara gjatevitit 2015. Keto veprime, jane ne perputhje te plotë me kerkesat e ligjit nr.9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe me Standartet Kombetare te Kontabilitetit, te dala ne zbatim te tij

Administrimi I fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera eshte bere nga Selia Qendrore. Deget financiare ne rrethe kane derdhur prane selise qendrore fondet e destinuar per kete qellim (kuotat e antarsise) dhe shpenzimet jane kryer dhe likujduar nga selia qendrore.

Per te dale ne konkluzione sa me te sakta auditori, ne kuadrin konceptual te te ardhurave dhe shpenzimeve, mori ne konsiderate ngjarje dhe fakte ekonomike financiare qe i takojne gjithe periudhes ushtrimore, 1 janar deri me 31 dhjetor 2015. Auditimi i situates financiare mori per baze gjitha dokumentacionin kontabel te mbajtur dhe raportuar gjate dhe ne fund te vitit 2015, rregjistrat kontabel si dhe gjithe dokumentacionin e nevojshem , gje qe mundesoi dhe krijimin e opinionit te Audituesit te Pavarur .

Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjëndjet e mjetet monetare në bankë dhe arkë, në lekë dhe në monedhë të huaj, në datat 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2014 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Gjendja ne 31.12.2015		Gjendja ne 31.12.2014		Ndryshimi
	Monedha	Ne leke	Monedha	Ne leke	
LLOGARI BANKARE					
Banka credins ne leke		4,797,697		994,144	3,803,553
Banka credins ne leke		1805		975	830
Banka credins ne GBP	11	4058		-21730	25,788
Banka credins ne euro	-17	-1,340	12	1,694	-3,034
Banka credins ne usd	829	102389	5.43	592	101,797
BKT ne leke		14,172		18,469	-4,297
Totali I llogarive bankare		4,918,781		994,144	3,924,637
Arka ne leke		444,361		473,239	-28,878
Shuma		5,363,142		1,467,383	3,895,759

Gjëndjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e llogarive rrjedhëse dhe konfirmohen nga nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në lekë duke përdorur kursin e këmbimit .

Aktive te tjera financiare afatshkurtra

Teprica e kerkesave te tjera per arketim per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2015 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2014	Ndryshimi
Aktive te tjera financiare afatshkurta			
<i>Kliente per mallra,produkte e sherbime</i>			
1	3,420,000	2,925,006	494,994
<i>Debitore,Kreditore te tjere</i>			
2	25,000	5,995,601	-5,970,601
3 Tvsh	5,393,255		5,393,255

4 Shuma	8,838,255	8,920,607	-82,352
----------------	-----------	-----------	---------

Ne llogarine kliente jane pasqyruar faturat e paarketuara per qiradhenie ambjenti si me poshte:

1-Alfa Zeta	2.600.000leke
2-ORD dajti shpk	820.000leke
Totali	3.420.000 leke

Ne llogarine "Debitore dhe kreditor te tjere" eshte pasqyruar paradhenie personeli ne shumen 25.000leke.

Ne llogarine TVSH eshte pasqyruar TVSH e mallrave te importuara per fushaten zgjedhore e cila duhet te perfshihej ne koston e mallrave.

Inventari

Teprica e Inventarit per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2015 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2014	Ndryshimi
1 Artikujt inventarial ne magazine	763851	807220	-43369
shuma	763851	807220	-43369

Inventari perbehet nga vlera kancelarie e te tjera gjendje ne magazine.Gjendja kontabel e artikujve ne magazine eshte e njejte me inventarin fizik ne fund te vitit.

Aktivet Afatgjata materiale

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve Afatgjata Materiale ne pasqyrat financiare paraqiten si vijon

Gjendjet dhe levizjet		Ndertesa	Mjete transporti	Makineri paisje	Aktive tjera afatgjata mater	Totali
A	kosto e AAM-ve me 01.01.2014	1,643,389	5,737,540	3,902,860	4,151,205	15,434,994
	Shtesat				751,801	751,801
	Paksimet					
	kosto e AAM-ve me 01.01.2015	1,643,389	5,737,540	3,902,860	4,903,006	16,186,795
B	Amortizimi AAM-ve me 01.01.2014		4,873,408			4,873,408
	Amortizimi ushtrimit		172,826			172,826

	Amortizimi per daljen e AAM-ve					
	Amortizimi AAM-ve me 01.01.2015		5,046,234			5,046,234
C	Zhvleresimi I AAM-ve 01.01.2014 shtesa pakesime Zhvleresimi I AAM-ve 01.01.2015					
D	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2014	1,643,389	864,132	3,902,860	4,151,205	10,561,586
<hr/>						
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2015	1,643,389	691,306	3,902,860	4,903,006	11,140,561

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe subjekti e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2015. Si politike kontabel per kontabilizimin e AAM-ve, subjekti ka zgjedhur modelin e kostos. Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar. Shpenzime amortizimi eshte llogaritur vetem per Mjetet e transportit. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e vleres se mbetur ne masen 20%.

Gjate vitit 2015 subjekti ka blere AAM ne shumen 751.801leke (paisje zyresh nje laptop dhe nje kompjuter) me fatura tatimore te cilat jane pasqyruar ne inventar.

Detyrimet Afatshkurtera-huate dhe parapagimet

Teprica e Detyrimet Afatshkurtera per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2015 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2014	Ndryshimi
1 Te pagushme ndaj furnitoreve	125,394,571	110,849,710	14,544,861
2 Te pagushme ndaj punonjesve			0
Detyrime per Sigurime Shoq. Shend. Tatimore	971,640	581,895	389,745
4 Huara te tjera			0
5 Shuma	126,366,211	111,431,605	14,934,606

"Te pagueshme ndaj furnitoreve" ne shumen 125.394.571 leke jane detyrimet ndaj furnitoreve per blerje mallrashe e sherbimesh gjendje pa u likuiduar ne fund te vitit

ushtrimor 2015. Furnitoret jane rritur ne shumen 14.544.861leke ne krahasim me vitin e kaluar .Kjo shume perbehet nga blerje sherbime medjatike(reklama, spote televizive) qe kane lidhje me fushaten zgjedhore vendore.Shuma e llogarise sintetike "Furnitor" eshte e barabarte me shumen e llogarite analitike te mbajtura per cdo furnitor.Lista e furnitoreve te palikuiduar te shoqeruar me faturat tatimore me 31 dhjetor 2015 ndodhet ne subjekt.

Detyrime per Sigurime Shoq.Shend. Tatimore ,perfaqesojne detyrimet per sigurimet shoq dhe shendetsore, TAP dhe Tatim ne Burim te muajit dhjetor 2015 respektivisht ne shumat 422.290 leke,340.850 dhe 208.500 leke.

Kapitalet e veta

kapitalet e veta te partise jane sa me poshte:

Pasuria Neto	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2014	Ndryshimi
1 kapitali	26,854,184	26,854,184	0
2 Teprica (mungesa) e fondeve te vitit te kaluar	(116,528,994)	(128,298,078)	11,769,084
3 Teprica (mungesa) e fondeve te vitit	(10,585,589)	11,769,085	-22,354,674
4 shuma	(100,260,399)	(89,674,809)	-10,585,590

Te ardhura dhe shpenzime

Te ardhurat dhe shpenzimet evidentohen ne nje rrjet te detajuar llogarish te cilat mundesojne kontrollin dhe marrjen ne kohe te informacionit.

Te Ardhurat

Partia Socialiste e Shqiperise gjate vitit 2015 ka realizuar te ardhura si me poshte:

Nr	BURIMET E TE ARDHURAVE	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2014	Ndryshimi
1	Te ardhurat nga Fondet e KQZ(Buxheti I Shtetit)	90,100,743	75,938,521	14,162,222
2	Te ardhura nga kuotat e anetaresimit	38,460,250	9,436,605	29,023,645
3	Te ardhura nga donatore private	18,490,000	1,384,124	17,105,876
4	Te ardhura nga qerate	2,411,750	5,745,000	-3,333,250
5	Te ardhura te tjera(interesa bankare)	17,544	-	17,544
	Shuma	149,480,287	92,504,250	56,976,037

Burimet e te ardhurave jane krijuar nga burime te ligjshme ne shumen 149.480.287 leke te realizuara si me poshte:

1-Financimi nga Buxheti i shtetit eshte bere me shkrese nr 1965/1 te Ministrise se Financave , me pese keste, ne shumen totale 90.100.743 leke ne degen e bankes credins.

2-Te ardhura nga kuotat e antaresimit ne shumen 38.460.250 leke.

3-Te ardhura nga donatore privat vendas ne shumen 18.490.000 leke

Donacionet janë kryer ne llogarine bankare te depozituar prane KQZ me nr. 00288405 prane Bankes Credins nga 20 dhurues , shtetas shqiptarë, të cilët kanë sponsorizuar me shuma parash deri në 1.000.000.00 lekë.

Nga verifikimet rezulton se te gjithë donoret kane nenshkruar deklaraten e mospasjes konflikt interesi ne zbatim te ligjit Nr.10019 date 29.12.2008"Kodi Zgjedhor i Republikes se shqiperise".Keto donator jane evidentuar dhe deklaruar ne rregjistrin e posacem te mbajtur sipas formularit te miratuar nga KQZ.Donacionet kane qene ne leke dhe nuk kane kaluar shumen 1.000.000leke per person.Fondet 16.940.000leke jane derdhur ne banke ndersa Fondet 1.550.000 lekë, të dhuruara nga anëtarësia jane dokumentuar hyrje në arkën e partise dhe pastaj jane derdhur ne banke me emra personale.Donacionet i perkasin periudhes se zgjedhjeve vendore.(Audituar nga auditi i zgjedhjeve vendore).

Auditi nuk konstatoi donacione ne natyre.

4-Te ardhura nga qerat etj ne shumen 2.429.294 leke.

Sipas te dhenave te mesiperme,burimi kryesor i te ardhurave eshte buxheti I shtetit, qe ze 60.2% te te ardhurave totale, 25.7% zene te ardhurat nga kuotat e antaresimit, 12.4% e zene te ardhura nga donoret ,1.7% e zene te ardhura nga qerate.

Shpenzimet .

Kostoja e personelit, paga dhe sigurimet shoqerore jane pasqyruar saktesisht si shpenzim ne vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

Konsumi i materialeve, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme..

Shpenzime personeli

Teprica e shpenzime personeli per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2015 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor2014	Ndryshimi
1 pagat	27,681,249	28,276,868	(595,619)
2 sigurimet shoqerore	2,958,262	2,594,315	363,947
Shuma	30,639,511	30,871,183	(231,672)

Shpenzime Amortizimi

Teprica e shpenzime amortizimi per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2015 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2014	Ndryshimi
1 amortizimi	172,826	216,736	(43,910)
Shuma	172,826	216,736	(43,910)

shpenzime amortizimi eshte llogaritur vetem per mjetet e transportit.

Furnitura ,nentrajtme dhe sherbime

Teprica e furniturave, nentrajtme dhe sherbime per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2015 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

Nr	Shpenzimet sipas natyres	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2015	Ushtrimi I mbyllur 31dhjetor 2014	Ndryshimi
1	Energji elektrike	1,473,573	1,298,492	175,081
2	uje	244,620	199,320	45,300
3	telekomi	1,906,006	1,868,518	37,488
4	udhetim e dieta	6,701,610	14,355,152	(7,653,542)
5	Kanceleri	210,742	486,476	(275,734)
6	Publicitet ,Reklame abonime	44,802,365	773,290	44,029,075
7	qera ambjenti	357,400	2,035,449	(1,678,049)
8	kuote antaresimi ne Europe	-	665,840	(665,840)
9	Konsulenca	14,207,736	8,103,604	6,104,132
10	karburant,servis automjeti	6,281,556	595,114	5,686,442
12	te tjera	6,457,469	19,214,283	(12,756,814)
14	shpenzime eventesh,	16,678,016		16,678,016

15	taksa vendore ,doganore	430,928		430,928
16	materiale promocionale	29,501,518		29,501,518
	Totali	129,253,539	49,595,538	79,658,001

Zeri , "Shpenzimet për publicitet, reklama televizive", në shumën 44.802.365 lekë, zënë pjesën kryesore ose 34.66 % të tyre. Keto shpenzime janë të dokumentuara , të vertetuara me fatura tatimore me tvsh.

Në tërësi, shpenzimet janë të dokumentuara me fatura tatimore apo mandat arkëtime të institucioneve buxhetore, që nuk janë subjekte tatimore, si dhe janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri.

Gjate vitit 2015 **Kapitalet e veta** (pasuria neto) të Partisë janë pakesuar në shumën 10.585.590 leke.

Te ndryshme

Financimi i fondit nga buxheti i shtetit në shumën 18.120.554 date 8.06.2015, donacionet nga antaret si dhe përdorimi i tyre nga Partia Socialiste, që ka lidhje me fushatën zgjedhore vendore Qershor 2015, është trajtuar në raportin e auditimit të fondeve të fushatës zgjedhore.

Alida Daija

Eksperte Kontabel e Autorizuar

Tirane më 1.11.2016